

MA Shpresa MEKAJ

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË SHËRBIMIN ARKIVOR

Përmbledhje: Mbrojtja e të dhënave personale është pjesë e rëndësishme e shoqërisë. Duke marrë parasysh këtë fakt, në këtë punim do të trajtojmë rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale në shërbimin arkivor. Që në shkurt të vitit 2019 në Kuvendin e Republikës së Kosovës është miratuar Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë informacione bazë për arkivistët lidhur me sfidat specifike për aplikimin e Ligjit NR. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, respektivisht Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (General Regulation on Data Protection - GDPR) në shërbimin arkivor. Punimi në fjalë iu adresohet institucioneve arkivore të cilat mbajnë dokumente arkivore që janë përzgjedhur për ruajtje të përhershme.

Fjalë kyçe: Arkivist, shërbimi arkivor, ruajtja e të dhënave personale, interes i publikut, arkivat

DATA PROTECTION FOR ARCHIVE SERVICES

Abstract: Personal Data Protection is an important segment of society. Given this fact, the paper is focused on the protection of personal data in the archives service. Since February 2019, the Assembly of the Republic of Kosovo has adopted the Law 06/L-082 on Personal Data Protection.

The purpose of this paper is to provide basic information to archivists regarding the specific challenges for the application of the Law No. 06/L-082 on Personal Data Protection, respectively the General Regulation on Data Protection (GDPR) in the archive service. The paper in question is addressed to archival institutions that hold archival documents selected for permanent retention.

Keywords: Archivist, archives service, protection of personal data, public interest, archives

Hyrje

Mbrojtja e të dhënave personale vlerësohet standard i rëndësishëm i nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, zbatimi i të cilit për vendet demokratike është

çështje shumë e rëndësishme. Faktor i rëndësishëm për përsheptimin e nevojës për mbrojtjen e të dhënave personale është zhvillimi i shpejtë i teknologjive informative. Forma tradicionale e grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave personale, që pothuajse tërësisht kryhej dhe arkivohej në mënyrë analoge, u transformua tërësisht në një koncept të ri prej çastit të përdorimit të teknologjive informative në përpunim të të dhënave personale. Ky zhvillim i teknologjive informative bëri të mundur përpunimin automatik të të dhënave personale nga subjektet shtetërore e, po ashtu, edhe ato private. Si rezultat i teknologjisë së re, ekspertë nga e gjithë bota demokratike po punojnë për krijimin e kornizave ligjore, ligjeve, rregulloreve dhe parimeve në shërbim të mbrojtjes së interesave të individëve kundër keqpërdorimit të të dhënave personale, qoftë nga institucione shtetërore, kompani private apo edhe individë.

Në Republikën e Kosovës e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale është e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Deri në vitin 2010 kjo çështje ka qenë e rregulluar me Ligjin nr. 02/L-23 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, të cilin e shfuqizon Ligji nr. 03/1-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Meqë Kosova është duke punuar me përkushtim të madh për integrimin në BE, edhe korniza ligjore është një element drejt këtij procesi. Andaj, për t'u harmonizuar me korniza ligjore të BE-së, në vitin 2019 në Kosovë u miratua Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është në përputhje me Rregulloren e BE-së 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës, 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave - General Regulation on Data Protection, së cilës në vazhdim do t'i referohem si GDPR).

Disa shtete evropiane kanë hartuar udhëzime për përdorimin e GDPR-së për shërbimet arkivore. Në këtë punim ne do t'i referohemi më shumë Grupit Evropian të Arkivave¹ si dhe Udhëzuesit për Arkivimin e të Dhënave Personale të hartuar nga Arkivi Kombëtar i Britanisë së Madhe. Këta udhëzues ofrojnë vetëm informacione dhe udhëzime themelore për arkivistët në lidhje me zbatimin praktik të GDPR-s në sektorin arkivor. Këto udhëzime janë të zbatueshme si për institucionet publike, po ashtu edhe për ato private dhe institucionet që mbajnë dokumente që janë zgjedhur për ruajtje të përhershme, duke përfshirë në radhë të parë arkivat kombëtare, shtetërore, rajonale dhe komunale, por edhe muzetë, bibliotekat, fondacionet dhe entitetet e ngjashme publike dhe private.

1 Grupi Evropian i Arkivave është grup zyrtar i ekspertëve të komisionit që u krijua në fillim të vitit 2006. Ai përbëhet nga përfaqësues të arkivave kombëtare në vendet anëtare të BE-së.

Përpunimi i të dhënave personale përgjithësisht është i ndaluar. Përrjashtim bëjnë rastet kur shprehimisht lejohet me ligj, ose subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunim. Pëlqimi apo miratimi është një nga gjashtë bazat më të njohura ligjore për përpunimin e të dhënave personale të përmendura në Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR). Të tjerat janë: kontrata, detyrimet ligjore, interesat jetike të subjektit të të dhënave, interesi publik dhe interesi i ligjshëm.

Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave përmbajnë përrjashtime të mundshme nga disa parime të cilat lidhen me arkivimin në interes të publikut. Këto përrjashtime përrfshijnë parashikime për përpunim të mëtejshëm të pajtueshëm, përtej qëllimit për të cilin u grumbulluan fillimisht të dhënat.²

Parimet e përrgjitshme që lidhen me përrpunimin e të dhënave personale

Përrpunimi i të dhënave personale duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe në transparente. Të dhënat mblidhen për t'i specifikuar qartë qëllimet e ligjshme dhe jo të përrpunohen në një mënyrë që nuk është në përputhje me qëllimin. Po ashtu, duhet të jenë adekuate dhe të kufizuara për aq sa është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato janë përrpunuar. Për ta arritur qëllimin arkivistët duhet të jenë të kujdesshëm që t'iu përmbahen parimeve të përrgjitshme që lidhen me përrpunimin e të dhënave personale të dhëna në nenin 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale³, që janë:

1. Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës - të dhënat personale përrpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

2. Parimi i kufizimit të qëllimit - të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përrpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime. Përrpunimi i mëtejshëm me qëllim të arkivimit për interes publik, qëllimit të hulumtimit shkencor ose historik, ose qëllimit statistikor, nuk konsiderohet që është në mospërputhje me qëllimin fillestar.

3. Parimi i minimizimit të të dhënave - të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar ose përrpunuar më tutje.

² Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, neni 16; neni 17 GDPR Right to erasure (*Right to be forgotten*).

³ Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, neni 4.

4. Parimi i saktësisë - të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimin e përpunimit, të fshihen dhe të korrigjohen pa vonesë.

5. Parimi i kufizimit të ruajtjes - të dhënat personale mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

6. Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit - të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.

7. Parimi i llogaridhënies - kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje ta zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara me këtë nen.

Për zbatimin e këtyre parimeve arkivistët duhet të jenë të vëmendshëm dhe të kujdesshëm sepse këto ndërlidhën shumë me punën praktike për shërbimet arkivore dhe për këtë mund të kenë pasoja. Arkivistët janë të njohur për ta siguruar parimin e “konfidencialitetit”, pasi është praktikë standarde në shërbimet e arkivit për ta mbrojtur informacionin konfidencial nga qasja e paautorizuar.⁴ Siç ceket te Grupit Evropian i Arkivistëve, por edhe në Udhëzuesin për Arkivimin e të Dhënave Personale, disa prej implikimeve të parimeve të tilla janë, megjithatë, më pak të dukshme. Për shembull:

- parimi i transparencës, përveç të tjerave, nënkupton që shërbimet arkivore duhet të botojnë informacione të qarta, miqësore për përdoruesit, në veçanti pse dhe si përpunohen të dhënat personale dhe se si subjektet e të dhënave mund t'u qasen atyre.⁵

- parimi i integritetit nënkupton keqpërdorimin arkivor që çon në humbjen e dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale dhe nuk përbën vetëm një shkelje të parimeve profesionale arkivore dhe ligjeve arkivore, por edhe një shkelje të ligjit në fjalë dhe të GDPR-së.⁶

⁴ <https://www.ica.org/en/ica-code-ethics> (lexuar për herë të fundit më 20.09.2020).

⁵ European Archives Group, GDPR, General principles, article 5, p. 8.

⁶ Po aty.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë, përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse të paktën një nga rrethanat specifike të listuara në nenin 5 vlen, duke përfshirë: “Subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale”; me interes të veçantë për arkivistët është kushti i përcaktuar në pikën 1.5, që përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm nëse “është i nevojshëm për kryerjen e një detyre të kryer në interes të publikut”.⁷

Ligji në fjalë ia lë përgjegjësinë Ligjit për Arkivat për të përcaktuar se cilat lloje të aktiviteteve konsiderohen “interes i publikut”. Ligji për Arkivat mund të përfshijë dispozita që përcaktojnë përpunimin e arkivave nga një institucion i caktuar, ose përpunimi i disa kategorive të arkivave si “një detyrë e kryer në interes të publikut”. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbron të dhënat e personave të gjallë dhe nuk aplikohet për të dhënat e personave të vdekur. Sidoqoftë, arkivistët duhet të marrin në konsideratë që Ligji për Arkivat mund ta bëjë këtë.

Pyetja që shtrohet këtu është se si një arkivist mund ta dijë që një person ka vdekur? Në të shumtën e rasteve nuk e di.⁸ Mirëpo, me arsyetim logjik mund të konstatojnë se një person i lindur para njëqind vjetëve nuk është më gjallë. Megjithatë, në shumë raste të tjera nuk do të jenë aq të qarta. Arkivistët do të duhet të bëjnë vlerësime rast pas rasti për mundësinë që fondet arkivore nën kujdesin e tyre do të përmbajnë të dhëna personale të individëve të gjallë.

GDPR lejon një numër përjashtimesh në favor të “qëllimeve të arkivimit në interes të publikut”. Recitali 158⁹ shpjegon kuptimin e kësaj shprehje: “Autoritetet publike ose organet publike ose private që mbajnë shënime të interesit publik duhet të jenë shërbime të cilat, në përputhje me ligjet e Bashkimit Evropian ose të shtetit anëtar, kanë detyrim ligjor të blejnë, ruajnë, vlerësojnë, rregullojnë, përshkruajnë, komunikojnë, promovojnë, shpërndajnë dhe sigurojnë qasje të regjistrave të vlerës së qëndrueshme për interes të përgjithshëm publik”.¹⁰

Nga ky shpjegim mund të shohim se nuk është natyra e arkivave ajo që përcakton nëse përjashtimi mund të zbatohet, por misioni i institucionit. Arkivistët duhet të konsiderojnë se një shërbim arkivor, i cili ka si mision ligjor marrjen, ruajtjen dhe sigurimin e qasjes në arkiva për interes të përgjithshëm publik, bien nën këtë përkuftizim. Këtu sigurisht bëjnë pjesë arkivat shtetërore dhe arkivat e tjera historike. Mirëpo arkivistët duhet të

⁷ Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, neni 5.

⁸ <https://www.nationalarchives.gov.uk/documents/information-management/guide-to-archiving-personal-data.pdf> (lexuar për herë të fundit më 21.09.2020).

⁹ https://www.dsgvo-portal.de/gdpr_recital_158.php parë (lexuar për herë të fundit më 22.09.2020).

¹⁰ Po aty.

jenë të vetëdijshëm se përjashtimet në favor të qëllimeve të arkivimit në interes të publikut kanë të bëjnë vetëm me përpunimin e të dhënave personale të përfshira në fondet dhe koleksionet arkivore që ato ruajnë. Duhet të kenë kujdes kur bëhet fjalë për shërbimet arkivore gjatë përpunimit të të dhënave personale të shfrytëzuesve të materialit arkivor ose të pjesëmarrësve në aktivitete të ndryshme, këto të dhëna nuk bëjnë asnjë përjashtim nga rregullat e përpunimit të të dhënave personale.

GDPR ka edhe një nen të veçantë dedikuar “masave mbrojtëse dhe përjashtimeve në lidhje me përpunimin për qëllime arkivore në interes të publikut, hulumtimeve shkencore apo historike ose statistikore”.¹¹ Përmes nenit 89 të GDPR-së përcaktohet se kur mund të bëhen përjashtime gjatë përpunimit të të dhënave personale për këto qëllime. Kuptohet se përjashtimet nuk janë automatike, por këto duhet t’u nënshtrohen kushteve dhe masave mbrojtëse e që përfshijnë zbatim të masave teknike dhe organizative. Përdorimi i përjashtimeve i nënshtrohet zbatimit të masave mbrojtëse të përshtatshme për të minimizuar çdo ndikim negativ në individët e gjallë. Kjo do të thotë se duhet të kemi një proces në funksion për të ndihmuar për identifikimin e sasisë minimale të të dhënave personale të nevojshme për arkivim. Për më tepër, parimi i minimizimit të të dhënave nënkupton që të dhënat që nuk përdoren më ose nuk duhet të ruhen më janë bllokuar dhe fshirë.

Rregullimin e këtyre përjashtimeve GDPR ua mundëson shteteve veç e veç përmes aprovimit të ligjeve, udhëzimeve administrative apo rregulloreve të veçanta të punës në shërbimet arkivore.

Kur flasim për përgjegjësitë e arkivave për mbrojtjen e të dhënave personale, duhet potencuar se institucionet dhe shërbimet arkivore që arkivojnë dokumente duhet mirë t’i kuptojnë parimet e përgjithshme, të drejtat e individëve dhe masat e veçanta mbrojtëse të cilat i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me të dhënat personale dhe menaxhimin e tyre, si dhe të sigurojnë që trajtimi i tyre të jetë në përputhje me ligjin. Shërbimet arkivore duhet të sigurojnë që politikat dhe procedurat janë në përputhje me legjislacionin, veçanërisht në lidhje me ruajtjen, sigurinë dhe qasjen në të dhënat personale.

Siç dhe e pamë më lart, të gjitha udhëzimet e GDPR-së bëjnë me dije se mbrojtja e të dhënave personale duhet të jetë në përputhshmëri me legjislacionin. Në këtë kontekst, vlerësojmë se edhe Ligji 04/L-088 për Arkivat Shtetërore, neni 12, paragrafi 6.4 dhe 6.6, kufizon shfrytëzimin e materialit kur cenohen të drejtat themelore të personave të tretë të garantuara me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale; si dhe kur çfarëdo dokumenti në përkujdesje të arkivave të Kosovës përmban

¹¹ European Archives Group, GDPR, General principles, article 89, p. 11.

informata ose të dhëna që mund t'i prekin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹²

Pa asnjë dyshim mund të themi se Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës është në përputhje dhe pajtueshmëri të plotë me GDPR-në dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në mesin e shumë udhëzimeve të GDPR-së hasim edhe në zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave brenda institucioneve kontrolluese/përpunuese të të dhënave, i cili, po të tjerash, duhet t'i ofrojë nivelit të lartë menaxherial ndihmë dhe këshilla rreth kësaj çështjeje. Edhe Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës¹³, më saktësisht në nenet 37, 38 dhe 39, përcakton qartë detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përfundim

Çfarë na mbetet tash? Të vlerësojmë, pas këtyre dokumenteve dhe të dhënave që paraqitëm, se arkivat janë kujtesë kolektive dhe personale, pjesë unike dhe e pazëvendësueshme e trashëgimisë sonë, vend ku ruhet ndërgjegjja e shoqërisë. Ato përmbajnë prova të besueshme të veprimeve dhe të vendimeve të së kaluarës. Pa dyshim që fondet dhe koleksionet arkivore përmbajnë informacione personale në lidhje me jetën publike dhe private të njerëzve, andaj duhet të jemi vigjilentë për trajtimin dhe shfrytëzimin e tyre, gjithmonë në pajtueshmëri me legjislacionin. Jemi të vetëdijshëm se vlera kulturore e arkivave ka të bëjë me përgjegjësinë afatgjatë. Ato na ofrojnë provat e kërkuara për t'i mbrojtur të drejtat e njerëzve, na mundësojnë të drejtat e lirisë së shprehjes dhe informacionit përmes hulumtimit duke qenë burim thelbësor për historianët, shkrimtarët dhe studiuesit. Për realizimin e aktiviteteve të tilla në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara, vazhdimësi kërkohet përditësim dhe pajtueshmëri e mjeteve juridike.

Mbrojtja e të dhënave personale nuk është një qëllim në vetvete dhe nuk e parandalon arkivimin. E mbështet atë. Gjithashtu, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mënyrë specifike njeh rëndësinë e arkivave dhe nuk ka asnjë konflikt të qenësishëm me arkivimin për interesin publik. Prandaj, me këtë temë të punimit përpoqëm t'i identifikojmë, t'i sqarojmë dhe t'i shpjegojmë ato dispozita që lidhen me përdorimin e të dhënave personale në arkivim. Punimi mbështet punën e vazhdueshme të rëndësishme të

¹² Ligji 04/L-088 për Arkivat Shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 4, Prishtinë, 19 mars 2012.

¹³ Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 6, Prishtinë, 25 shkurt 2019.

arkivistëve, ruajtjen dhe vënien në dispozicion të të dhënave për nevojat e shoqërisë tani dhe në të ardhmen.

Bibliografi:

Ligji 04/L-088 për Arkivat Shtetërore. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 4, 19 mars 2012, Prishtinë

Ligji 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 6, 25 shkurt 2019, Prishtinë

European Archives Group, Guidance on Data Protection for Archive Service;

<https://www.ica.org/en/ica-code-ethics>

https://www.dsgvo-portal.de/gdpr_recital_158.php

<https://www.nationalarchives.gov.uk/documents/information-management/guide-to-archiving-personal-data.pdf>